

## **Konsultim me publikun për draft raportin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social për Nën-projektin "Rikonstruksioni i rrugës Fier-Seman"**

Më 15 janar 2018, u organizua në bashkinë Fier, konsultimi me publikun për prezantimin e draft raportin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social për Nën-projektin "Rikonstruksioni i rrugës Fier-Seman". Takimi që u zhvillua pranë Shkollës së mesme bujqësore 'Rakip Kryeziu', Ferma Çlirimi, pati si pjesëmarrës përfaqësues të: Bashkisë Fier, te OSHE Fier, banorë të zonës, etj. (Lista e pjesëmarrësve në fund të këtij dokumenti)

Nënprojekti për " Rikonstruksioni i rrugës Fier -Seman", pritet të financohet nëpërmjet huasë së Bankës Botërore për qeverinë shqiptare, që do të zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, sapo të miratohet projekti "Rehabilitimi i rrugëve lidhese rajonale dhe lokale"

Ky draft i VNMS për këtë rrugë është përgatitur nga Njëësia e Mjedisit e Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe u bë i aksesueshëm për publikun pas publikimit të dokumentave në faqen zyrtare të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si dhe të shpërndarëa përmes mediave sociale (Facebook).

[http://www.albaniandf.org/Resources/Publikime/publikime%20te%20tjera/ESIA\\_Fier\\_Seman\\_shqip.pdf](http://www.albaniandf.org/Resources/Publikime/publikime%20te%20tjera/ESIA_Fier_Seman_shqip.pdf)

Pjesëmarrësit u informuan në lidhje me:

- Vendndodhjen e projektit
- Llojin e ndërhyrjeve të parashikuara gjatë projektit
- Permbledhje të daftit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social
- Ndikimet mjedisore dhe sociale të nënprojektit
- Masat zbutese mjedisore dhe sociale të nënprojektit.

### ***Përmbledhje e komenteve dhe rekomandimeve të pjesëmarrësve.***

Takimi u hap nga N/Kryetari i bashkisë Fier z.Florian Mucaj, i cili u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve dhe bëri një prezantim të shkurtër të nënprojektit.

Z. Ervin Paci, Projektuesi, përshkroi projektin në detaje dhe se si ai ndërthuret me zhvillimet e fundit urbane në zonën e këtij projekti.

Z. Genti Çupi, përfaqësues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, prezantoi draftin paraprak të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social, që përfshin ndikimet e parashikuara dhe masat zbutëse të rekomanduara. Prezantimi u fokusua dhe ne çështjet dhe procedurat e shpronësimit, megjithëse në rastin e rehabilitimit të rruges Fier-Seman nuk parashikohet të ketë shpronësime pasi do të bëhet rikonstruksioni i shtratit aktual të rrugës. Pas prezantimit u ngritën disa pyetje nga pjesëmarrësit, të cilat morën përgjigje nga përfaqësuesit e kompanisë së projektimit dhe përfaqësuesve të FSHZH të pranishëm në takim. Diskutimet ishin si më poshtë:

Z. Florian Muçaj, Bashkia Fier, duke komentuar vlerësimet për kapacitetin e rrugës tha, duhet të kemi parasysh se matjet e trafikut të bëra tani paraqesin një realitet krejt tjetër me trafikun që do të bëhet kur të përfundojë bypassi i Fierit, sepse të gjithë banorët e Fierit, Rockovecit, Patosit etj, do të kalojnë në këtë rrugë duke e rënduar trafikun, gjithashtu edhe plazhi, që tani nuk është kaq i frekuentuar për shkak të cilësisë së rrugës do të sjellë rritje të frekuentimit të rrugës.

Përgjigje z. Ervin Paci - Nga matjet e trafikut të bëra nga ARRSH, del që lëvizin nga Fieri në –Vlore 15.000 makina në dite, ne kemi supozuar se këndej do të kalojnë 60% e tyre, dhe me standartet e rrugës që po projektojmë, është plotësisht e përballeshme, kemi ndalim trafiku të parashikuar për vetem 30 orë në vit

Z. Dilaver Shyti , Administrator i njësisë Dërmenas- Rruga duhet të ketë korsi bicikle nga të dy anët sepse ka shumë fluks lëvizje me bicikleta gjatë verës....dhe është e pamundur lëvizja vetëm në një korsi

Alush Vrenozi , Banor i zonës - A parashikohet zgjerim të rrugës përtej shtatit aktual të rrugës, sepse ne kemi pronat tona me dokumentacion të rregullt përtej kanalit kullues??

Oltion Kadaifciu - Në asnjë rast nuk do të kemi zhvendosje të pavullnetëshme me force të popullsisë ,për çdo rast nqs do preken pronat, pronarët do demshpërblehen me rregullat e BB.Në këtë rehabilitim rrugë nuk do të kemi zgjerim të saj por vetëm rikonstruksionin e asaj egzistuese....

Z. Dilaver Shyti - Në Afrim kemi një zonë informale që permbytet vazhdimisht(ish kënetë e Hoxharës) dhe ky kanal që presupozohet të mbulohet nuk e di në e përballon gjithë fluksin e drenazhimit të këtyre tokave,gjithëashtu në këtë zonë nuk ka as kolektore të ujrave të zeza e linja për ujë të pijshëm?

A është parashikuar në shtresat e rrugës duke pasur parasysh edhe se këtu kemi herë – pas here humbje të tokës për shkak të prezencës së ujit??

Përgjigje z.Ervin Paci - Rruga në vetevete është bërë që të përballojë një stuhi një herë në 50 vjet...kanali është marrë ne seksionin egzistues në kapacitetin e tij dhe ai që do të futet në beton , nqs ky kanal s'e përballon do të flitet me specialistët e M.Bujqësisë për të parë mundësinë e zmadhimit të seksionit të kanalit,sasia e tombinave do të dyfishohet në krahasim me numrin e atyre egzistuese...

Romeo Pasha, FSHZH - Për këtë zonë duhet të parashikohet edhe shtesë me gjeotekstil por edhe sistem drenazhimi të veçantë, duhet të mbahet parasysh edhe lënia e vendit për linjën e ujësllësit.

Yzeir Grenica , Kryeplak i fshatit Seman - Nqs është e nevojshme të priten ose të zhvendosen pemët , por rruga duhet zgjeruar patjeter edhe në fundin e saj, pemët mund te mbillen jashtë trasesë së rrugës.

Genti Cupi, FSHZH - Në rregullat e dhënies së VNMS nuk parashikohet prerja e pemëve pa miratimin paraprak të organeve përkatëse, por edhe politikat e ndjekura nga BB, asnjëherë nuk parashikohet prerja e pemëve , maksimumi është zhvendosja e tyre po në atë zonë me makineri të posacme për këtë proces dhe të mbillen edhe peme të reja ngjitur me trasenë e rrugës.

Lindita Shahini , banore e zonës - A është parashikuar hyrje dalje për automjetet tona tek shtëpitë e banimit????

Dritan Pistoli, FSHZH: Në cdo projekt të BB aksesit i fermerëve me rrugen mbetet prioritet, prandaj sigurisht që do parashikohet edhe në këtë projekt hyrja e dalja e mjeteve motorike të banorëve të zonës në këtë rrugë pas rikonstruksionit...

**FOTODOKUMENTIM**





**LISTA E PJESMARRËSVE**

**Konsultim me publikun për "Rehabilitimin e Rrugës Fier - Seman"**

15 janar 2018, në ora 11:00  
Ferma

Nr.	Emri	Institucioni	Email /Tel	Firma
1	Hershi Vercosa	Banor		
2	Xhevdet Hoxha	Banor		
3	Edmarta Shalmani	-/-		
4	Alush VREDET			
5	LOJHIN-DEVED - VREDET			
6	GEZIM VREDETI			
7	Nikolova Nolke			
8	Asbin Nalceko			
9	Luqdash Hoxha			
10	Amirida Pshu			
11	Sotir Zolke			
12	Mirza Kocaj			
13	Yolte Memaj			
14	ARIF KRASHI	BANOR		

FONDI SHQIPTAR I ZHYLLIMIT  
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND



15	YEZIR GENIQA	KRYEPIAK				
16	Mehmet Celo					
17	Arsim Egdol					
18	Dilaver Shyti	Myria Dervanas	alloshyti@gmail.com			
19	Edmond Selaj	Balib. Pe	0695314571			
20	Marsela Kumpi	W. RUC 3				
21	Ermelinda Gjele	Tron Adam Nr 4				
22	Kristofor Gumi	Kondumabor				
23	Altan Hoxaj	Shp. Dega Teknike	OSHEER-FR.			
24	Ardit Pashaj	Kllp OSHEETL				
25	Gea. Bleva	BR NITL OSHEE				
26	ELDRIN UCAT	Z/krasni i hesho Fier				
27	Oliver Kodol Fier	AD F	Dikati FC U OSHEER: 0695314571			
28	Loreo Pashaj	AD F	v posteo@ACKSHIMI/AD.F.SG			
29	Dutban Pishaj	A.H.F.	shkollor@shkollor.f.org			
30	Genti Cezari	F.SH. 24	geuri@shkollor.f.org			
31	ERVIN PHATI	AVE. Kousellor				